



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E AKREDITIMIT
DREJTORIA E ZHVILLIMIT

Nr. 515 prot.

Tiranë, më 12.12.2023

URDHËR

Nr 58 datë 12.12.2023

**PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS SË RISHIKUAR TË
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË AKREDITIMIT (DPA)**

Në mbështetje të nenit 5 të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit” i ndryshuar me ligjin Nr. 78 datë 21.09.2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, si dhe shkresës Nr. 222 Prot datë 05.12.2023 “Mbi detyrimet sipas ligjit ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” i ndryshur,

URDHËROJ:

1. Miratimin e Programit të Transparencës së Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit (DPA) sipas formës dhe përmbajtjes së miratuar me Urdhrin Nr. 187, datë 18.12.2020 “Për miratimin e Programit të Transparencës së rishikuar”.
2. Përmbajtja e Programit të Transparencës së DPA jepet në Aneksin bashkëlidhur këtij Urdhri dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të DPA www.dpa.gov.al në menyne “Programi i Transparencës”.
3. Ngarkohet të gjitha drejtoritë dhe Koordinatori për të Drejtën e Informimit për të bashkërenduar punën për bërjen publike, sa herë është e domosdoshme, të çdo dokumenti në funksion të Programit të Transparencës së rishikuar.
4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTORI PËRGJITHSHËM

Pranvera FAGU



Konceptoi: Brikena Hasa
Miratoi: Suela Mustafaraj
Datë: 11.12.2023